

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7030
E mërkurë, 25 tetor 2023
Çmimi 0.50 €

**Kurti në Greqi: Serbia,
e ndihmuar nga aleanca
me Putinin, kërcënim
për demokracinë** | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

MOSBESIMI I SHPREHUR I PRESIDENTES NË PROKURORI, SINJAL JO I MIRË



Ende nuk dihet nëse Prokuroria e Shtetit ka nisur ndonjë hetim lidhur me "presionet" dhe "kërcënimet" ndaj presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, të cilat ajo pretendon se i ka pasur gjatë procesit për dekretimin e Kryeprokurorit të Shtetit. E pyetur

nga gazetarët se a ka deponuar denoncim tek organet hetuese, Osmani ka thënë: "Kjo do të duhej të ishte procedura në rastet kur funksionon një sistem i drejtësisë. Kjo është sikur të thuash: shko dhe deponoje pikërisht tek ata që të kanë

kërcënuar". Arton Demhasaj nga organizata joqeveritare "Çohu", ka pohuar se nëse presidentja kërcënohet dhe nuk i paraqet këto kërcënime tek institucionet relevante, atëherë si mund të besojnë qytetarët për t'i paraqitur këto raste

OPINION

**VETËM MENDJET
E ÇORODITURA PRODHONË
KONFLIKT ME REALITETIN:
KOSOVA SI RAST** F.7

Milazim
KRASNIQI



AKTUALE



**ZLLATAN ELLEK, KRYETAR
I RI I LISTËS SERBE** F.6

**TAHIRI: ÇFARË PO NDOH?
KOSOVËS NUK IU HOQËN
NDËSHKIMET, DIPLOMACIA
JONË NË GJUMË** F.3

EKONOMI



**ASETET E BANKAVE KOMERCIALE
NË KOSOVË NË MUJIN SHTATOR
KANË SHËNUAR RRIJTE
67.6 MILIONË EURO** F.8

SPORT



**FUTBOLLI BASHKON TË RINJTË,
FAMILJET, PËRFAQËSUESIT
INSTITUCIONALE DHE
NDËRKOMBËTARË** F.10

**KMDLNJ: PSE
'QEVERIA E MADHE'
NUK DEKLAROHET
PAS TAKIMIT
ME PESËSHEN
E MADHE?** | FAQE 3



**MBAHET KONFERENCA
E SIGURISË
KIBERNETIKE
'DEFENDX23',
BËHET THIRRJE TË
MBROHEN TË DHËNAT
PERSONALE** | FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Obama i bën thirrje Izraelit ta respektojë ligjin ndërkombëtar

WASHINGTON, 24 TETOR - Ish-presidenti i Shteteve të Bashkuara, Barack Obama, i bëri thirrje Izraelit më 23 tetor të jetë i matur në operacionet ushtarake në Rripin e Gazës, pas sulmeve të 7 tetorit nga grupi militant Hamas në qytetet jugore izraelite. "Në veçanti, ka rëndësi, siç e ka theksuar vazhdimisht presidenti Biden, që Ushtria e Izraelit t'i përmbahet ligjit ndërkombëtar, përfshirë ligjeve të cilat kërkojnë shmangien e vdekjeve dhe vuajtjeve të popullatës civile", shkroi Obama në platformën online "Medium". Mijëra palestinezë kanë vdekur tashmë si pasojë e bombardimeve në Gazë, shumica e të cilëve fëmijë, tha ish-presidenti amerikan, duke shtuar se qindra mijëra njerëz në

këtë vend janë zhvendosur. Obama theksoi se pas "brutalitetit të papërshkrueshëm" nga Hamasi, Izraeli ka të drejtë t'i mbrojë qytetarët e vet nga dhuna e tillë, por "bota po shikon me vëmendje". Izraeli është duke bombarduar paseshtur Rripin e Gazës qëkur Hamasi kreu sulme të tërbuara më 7 tetor në qytetet jugore izraelite, ku i vrau mbi 1 400 njerëz. Si pasojë e sulmeve ajrore izraelite janë vrarë më shumë se 5 000 palestinezë, sipas zyrtarëve në Gazë. "Vendimi i Qeverisë së Izraelit për ta ndërprerë furnizimin me ushqim, ujë dhe rrymë për një popullsi civile të rrethuar, kërcënon jo vetëm përkeqësimin e krizës humanitare në rritje, por mund ta

ashpësojë edhe qëndrimin palestinez për gjenerata me radhë, ta shkatërrojë mbështetjen globale për Izraelin, t'u japë përparësi armiqve të Izraelit, dhe t'i minojë përpjekjet afatgjatë për arritjen e paqes dhe stabilitetit në rajon", shtoi Obama. Ai e mbështeti plotësisht presidentin amerikan Joe Biden, i cili u zotua për ta përkrahur Izraelin për "luftimin e Hamasit, çarmatimin e tij, si dhe ndërmjetësimin e kthimit të sigurt të qindra pengjeve të familjet e veta". Obama theksoi se është e kuptueshme që shumë izraelitë kanë kërkuar që qeveria e tyre të bëjë gjithçka që nevojitet për ta rrënuar Hamasin dhe për t'u siguruar që sulmet nga Hamasi nuk ndodhin më kurrë.



Spanjë, socialistët dhe majtistët arrijnë marrëveshje për koalicion qeveritar

MADRID, 24 TETOR - Partia Socialiste e Spanjës dhe partia e ekstremit të majtë, Sumar, thanë të martën se kanë arritur marrëveshje për formimin e qeverisë së re, një hap i rëndësishëm për rizgjedhjen e kryeministrit në detyrë, Pedro Sanchez, për edhe një mandat tjetër. Spanja përballet me një ngërç të zgjatur politik pas zgjedhjeve të përgjithshme të korrikut, të cilat i fitoi Partia Popullore konservatore (PP), por pa mbështetje të mjaftueshme për ta formuar qeverinë. Muajin e kaluar, lideri i PP-së, Alberto Nunez Feijoo, humbi në një votim vendimtar parlamentar për t'u zgjedhur kryeministër. Sanchez, partia e të cilit përfundoi



në vendin e dytë, e ka mundësinë tani. Përkrahja e Sumarit është vendimtare, por e pamjaftueshme për t'u siguruar

se ai do ta kalojë votën e besimit në dhomën e ulët të Parlamentit. Sanchez ka ende nevojë për mbështetje nga parti më të vogla rajonale, përfshirë nga

separatistët katalonas të linjës së ashpër, JxCat. Marrëveshja e arritur në mes të socialistëve dhe Sumerit përfshin edhe kërkesën për shkurtimin e orëve të punës pa i ulur pagat dhe një plan kundër papunësisë tek te rinjtë. "Kjo marrëveshje për qeverinë për një mandat legjislativ katërvjeçar do t'ia mundësojë vendit tonë ta vazhdojë rritjen e qëndrueshme, si dhe punësimin cilësor dhe zhvillim të politikave bazuar në drejtësinë shoqërore dhe klimatike", thanë këto dy parti. Sanchez, i cili mori pushtetin më 2018, dhe shefja e Sumerit, ministrja në detyrë e Punës, Yolanda Diaz, do ta ratifikojnë zyrtarisht marrëveshjen këto dy

ditë në Madrid. Nuk është caktuar data se kur do të përballet Sanchez me votën e besimit në Parlament. Nëse asnjë kandidat për kryeministër nuk e siguron shumicën deri më 27 nëntor, atëherë zgjedhjet do të përsëriten në janar. Në këmbim të mbështetjes vendimtare, JxCat po kërkon amnisti për qindra politikanë dhe aktivistë të cilët përballesh me veprime ligjore për rolin e tyre në përpjekjen e dështuar të Katalonjës për ndarje nga Spanja më 2017. Kjo kërkesë i ka zemëruar djathtistët dhe disa zyrtarë në partinë e Sanchezit, të cilët argumentojnë se do ta rrezikonte sundimin e ligjit.

Erdogani ia dërgon Parlamentit turk protokollin për pranimin e Suedisë në NATO

ANKARA, 24 TETOR - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ia ka dërguar Parlamentit turk për ratifikim protokollin për pranimin e Suedisë në NATO, njoftoi zyra e tij. Ky vendim e sjell më afër shtetin nordik për anëtarësim në aleancën ushtarake. Erdogan e kishte vonuar ratifikimin e anëtarësimit të Suedisë, duke e akuzuar Stokholmin se ka qenë i butë ndaj militantëve kurdë dhe grupeve të tjera që gjenden në këtë shtet, e që Turqia i konsideron si kërcënime për sigurinë e saj. Po ashtu, Ankaraja

është zemëruar me djegien e kopjeve të Kuranit - librit të shenjtë të myslimanëve - në protestat në Suedi. Të 31 anëtarët e NATO-s duhet ta mbështetnin anëtarësimin e Suedisë. Turqia dhe Hungaria janë të vetmet anëtare të aleancës që ende nuk e kanë ratifikuar atë. Përmes një deklaratë të shkurtër, Presidenca turke tha se Erdogan ka nënshkruar protokollin për pranimin e Suedisë në NATO, i cili i është dërguar Asamblesë Kombëtare turke. Megjithatë, në njoftim nuk është bërë me dije se kur do të jetë kjo çështje në rend

dite në Parlamentin turk. Suedia e mirëpriti këtë vendim. "Gëzohem që presidenti turk Erdogan tani ia ka dërguar dokumentet për ratifikim Parlamentit turk", tha kryeministri suedez Ulf Kristersson në "X". Suedia dhe Finlanda u deklaruan se duan t'i bashkohen NATO-s pasi Rusia nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës shkurtin e vitit të kaluar. Finlanda iu bashkua aleancës në prill, pasi Turqia hoqi pengesat e saj për anëtarësim, duke theksuar se Helsinki kishte adresuar shqetësimet e sigurisë së Ankarasë.



KMDLNj: Pse 'qeveria e madhe' nuk deklarohet pas takimit me pesëshen e madhe?

PRISHTINË, 24 TETOR - Të shtunën e kaluar, një grup ndërkombëtar i cilësuar si "Pesëshja e madhe", u takua në Prishtinë me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, pas të cilit takim opinionioni në Kosovë nuk u informua fare për rrjedhën e këtij takimi dhe përmbajtjen e bisedimeve.

Ndaj kësaj situate ka reaguar KMDLNj-ja, duke theksuar se Kurti si mënyrë të komunikimit me qytetarët dhe opozitën nuk e konsideron as si pjesë të qytetarisë. Sipas KMDLNj-së, ai e zgjodhi gjuhën e peshkut - gjuhën e heshtjes gjë që në opinion ngjalli shumë dyshime për porosinë që e solli "Pesëshja e madhe" në Prishtinë. "Qeveria e Kosovës, përkatësisht KM Kurti është qeveria dhe KM më jotransparent, sidomos sa i përket bisedimeve me Serbinë duke mos i dhënë llogaridhënie askujt, madje as deputetëve të Kosovës e që e kanë të detyruar ta bëjnë këtë. Nuk duhet të kthehem shumë kohë prapa e të bëjmë krahasime se sillej LV-ja sa ishte në opozitë në Kuvendin e Kosovës me anëtarët e delegacionit që bënte negociata me Serbinë; nuk linte mjetet pa përdorur për të kundërshtuar këto bisedime sikur që sulmonte me të gjitha mjetet e mundshme, të dhunshme kryesisht, anëtarët e delegacionit duke i akuzuar për mungesë të transparencës dhe



llogaridhënies. Qeveria aktuale me KM Kurti në krye, mungesën e transparencës dhe llogaridhënies e mbështjellin me një mbështjellëse që mbulon çdo gjë përveç të vërtetës, me ruajtjen e parimit e konfidencialitetit dhe kërkesën e ndërkombëtarëve që të mos flitet në publik për këtë. Arsyeitim amortizues për marrëveshje që

kanë prodhuar dhe do të prodhojnë pasoja të dëmshme për Kosovën", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. KMDLNj thekson se kryeministri Kurti me një fuqi absolute politike që ka, me një opozitë që me asgjë nuk i ngjanë opozitës, me një pjesë të shoqërisë civile nepotiste dhe klienteliste, me një pjesë të medieve të kontrolluara

me dashje apo me privilegje, nuk e ka asnjë rrezik për postin që e ka sikur që me asgjë nuk i rrezikohet vendimmarrja. "Prandaj edhe është e habitshme, e pakuptueshme dhe e papranueshme kjo mbyllje dhe mosgatishmëri për të komunikuar haptas me qytetarët për vendime që janë përcaktuese për të ardhmen e qytetarëve",

është theksuar në reagimin e KMDLNj-së, duke shtuar se opozita duhet t'i lë anash të gjitha temat tjera dhe të këmbëngul nga Kurti që të tregojë se çka në të vërtetë kanë sjell ndërkombëtarët në tavolinën e kryeministrit Kurti të shtunën e kaluar dhe se sa është kjo e pranueshme për Kosovën. "Arroganca e numrave dhe opozita krejtësisht impotente e Kosovës e ka shndërruar KM Kurti në shpërfillës të detyrimeve kushtetuese që të raportojë në Kuvendin e Kosovës dhe se ky raportim nuk mund të kushtëzohet me asgjë, siç po ndodhë tani. KM Kurti e ka shumë të qartë se propozimi i 'Pesëshes së madhe' nuk është i mirë për Kosovën andaj me çdo kusht po përpiqet të blejë kohë duke e shtyrë sa më shumë që të jetë e mundur ekzekutimin apo realizimin e rezultatit përfundimtar, mundësisht deri në zgjedhjet e ardhshme. Është koha e fundit që KM i Kosovës, Albin Kurti t'i drejtohet deputetëve të Kuvendit të Kosovës, si përfaqësues të zgjedhur të popullit dhe t'i informojë për ecurinë e bisedimeve dhe propozimet që i janë bërë nga 'Pesëshja e madhe' pas së cilës do të kërkonte përkrahjen e tyre në ndërtimin e një konsensusi politik, kombëtar dhe shtetëror", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

Kurti në Greqi: Serbia, e ndihmuar nga aleanca me Putinin, kërcënim për demokracinë



ATHINË, 24 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në panelin diskutues të organizuar nga "The Economist", me temën "Thellimi i solidaritetit: Si mund të dalë Evropa më e fuqishme nga trazirat aktuale gjeopolitike?". Në fjalën e tij ai theksoi se "momenti aktual kërkon mbështetje të palëkundur për demokracinë dhe mbrojtësit e saj. Ne duhet të bashkohemi si forca që kundërshton elementet destabilizuese që përbëjnë një kërcënim të madh për demokracinë". Pasi prezantoi realitetin në

Kosovë dhe sukseset e vendit tonë, kryeministri Kurti shtoi se: "Demokracia është një realitet konkret për ne, po ashtu janë edhe kërcënimet e paraqitura nga autokracitë, kryesisht Serbia, e ndihmuar dukshëm nga aleanca e saj me Putinin". Kryeministri përmendi edhe sulmin terrorist të 24 shtatorit që ndodhi në Banjaskë të Zveçanit. "Më 24 shtator, një muaj më parë, agresioni që kemi parë kulmoi kur trupat e armatosura paraushtarake që ishin trajnuar në bazat zyrtare ushtarake në Serbi hynë në vendin tim dhe hapën zjarr ndaj forcave të policisë, duke vrarë

një nga policët tanë. Në njëjtën kohë, Serbia u angazhua në atë që ShBA e përshkruan si një ngritje ushtarake 'të paprecedentë' përgjatë kufirit tonë. Në ditët që pasuan, një sasi e konsiderueshme provash tregonin përfshirjen dhe planifikimin e një pushtimi më të madh nga vetë shteti", tha Kurti. Ai shtoi se ky fakt ishte i vetëkuptueshëm, pasi asnjë grup civilësh nuk mund të grumbullonte një armatim të tillë dhe ta transportonte atë përtej kufijve pa të paktën mbështetjen e heshtur të një qeverie.

Tahiri: Çfarë po ndodh? Kosovës nuk iu hoqën ndëshkimet, diplomacia jonë në gjumë

PRISHTINË, 24 TETOR - Ish-kryenegociatorja për dialogun Kosovë - Serbi, Edlita Tahiri, thotë se diplomacia e Kosovës është në gjumë. Tahiri në "Facebook" ka bërë këtë deklaratë pasi Kosova është

ende nën masat e BE-së. "Çfarë po ndodh? Kosovës nuk iu hoqën ndëshkimet ndërkombëtare ndërsa Serbia ende e pandëshkuar! Diplomacia jonë në gjumë!"; ka shkruar Tahiri. E për procesin e dialogut Kosovë -

Serbi ajo ka thënë se ky proces nuk duhet të vazhdojë pa u ndëshkuar njëherë Serbia. "Dialogu nuk ka alternativë, por pa u ndëshkuar Serbia, qeveria jonë mos të shkojë", është shprehur Tahiri.





Mosbesimi i shprehur i presidentes në Prokurori, sinjal jo i mirë

Ende nuk dihet nëse Prokuroria e Shtetit ka nisur ndonjë hetim lidhur me “presionet” dhe “kërcënimet” ndaj presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, të cilat ajo pretendon se i ka pasur gjatë procesit për dekretimin e Kryeprokurorit të Shtetit. E pyetur nga gazetarët se a ka deponuar denoncim tek organet hetuese, Osmani ka thënë: “Kjo do të duhej të ishte procedura në rastet kur funksionon një sistem i drejtësisë. Kjo është sikur të thuash: shko dhe deponoje pikërisht tek ata që të kanë kërcënuar”. Arton Demhasaj nga organizata joqeveritare “Çohu” ka pohuar se nëse presidentja kërcënohet dhe nuk i paraqet këto kërcënime tek institucionet relevante, atëherë si mund të besojnë qytetarët për t’i paraqitur këto raste

PRISHTINË, 24 TETOR - Ende nuk dihet nëse Prokuroria e Shtetit ka nisur ndonjë hetim lidhur me “presionet” dhe “kërcënimet” ndaj presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, të cilat ajo pretendon se i ka pasur gjatë procesit për dekretimin e Kryeprokurorit të Shtetit. Presidentja Osmani, në një konferencë për medie më 17 tetor, ka njoftuar se nuk e ka dekretuar Blerim Isufajn për Kryeprokuror të Shtetit, emrin e të cilit ia ka propozuar Këshilli Prokurorial i Kosovës qysh më 8 prill të vitit 2022.

Për ta arsyetuar veprimin e saj, presidentja e Kosovës ka thënë se janë gjetur disa shkelje ligjore në procesin e përzgjedhjes dhe se ka pasur “presione të paligjshme” dhe “kërcënime” nga njerëz të caktuar. “Dërgonin mesazhe se në qoftë se nuk e dekreton, nuk e nënshkruan, do të bëjmë dosje, do të ngremë aktakuza, do t’ju lidhim duart e të tjera”, ka thënë Osmani.

E pyetur nga gazetarët se a ka deponuar denoncim tek organet hetuese, Osmani ka thënë: “Kjo do të duhej të ishte procedura në rastet

kur funksionon një sistem i drejtësisë. Kjo është sikur të thuash: shko dhe deponoje pikërisht tek ata që të kanë kërcënuar”.

Nga Presidenca e Kosovës nuk iu përgjigjën pyetjes së REL-it nëse Prokuroria i është drejtuar tashmë këtij institucioni për procedura të mëtejshme.

Denoncimi i veprës penale në hetuesi, “detyrë kushtetuese e presidentes”

REL-i pyeti edhe Prokurorinë e Shtetit nëse ka nisur ndonjë hetim lidhur me pretendimet e presidentes Osmani për “presione dhe kërcënime” ndaj saj, por zëdhënësi Ekrem Lutfiu tha se “ende nuk ka ndonjë përgjigje” lidhur me këtë çështje.

Ish-nënkryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Kadri Kryeziu, thotë për “Radion Evropa e Lirë” se detyrë e Prokurorisë është të veprojë mbi bazën e kallëzimeve penale individuale dhe kolektive. Kërcënimet, sipas tij, paraqet vepër penale.

Kryeziu thotë se Prokuroria e ka për detyrë ndjekjen e kryerësve të veprës penale ‘ex officio’, që do të

thotë në bazë të detyrës, por edhe në bazë të informacioneve në mjetet e informimit.

Kodi Penal i Kosovës, sipas Kryeziut, obligon ligjërisht çdo qytetar të rëndomtë ose autoritet të shtetit që t’i njoftojë organet e hetuesisë në rast se ka njohuri për një vepër penale. “Përgjegjësia është shumë më e madhe tek autoritetet e larta të shtetit. Presidentja e shtetit ka pasur detyrë kushtetuese dhe ligjore që t’i njoftojë organet kompetente para se ta njoftojë publikun. Përndryshe, ky është veprim dhe koncept i gabuar i udhëheqjes së Presidencës së Republikës së Kosovës”, thotë Kryeziu.

Arton Demhasaj nga organizata joqeveritare “Çohu” në Prishtinë thekson se deklarata e presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, me pretendimet se i është bërë presion dhe është kërcënuar, dërgon sinjale tejet negative te qytetarët e vendit. Sipas tij, ata mund ta krijojnë perceptimin se institucionet më të larta të vendit janë adresë e lehtë ku mund të dërgohen kërcënime ose të bëhet presion. Për më shumë, thotë ai, sinjal të keq dërgon edhe mosparaqitja e rasteve të kërcënimeve në organet e hetuesisë. “Pra, nëse presidentja kërcënohet dhe shantazhohet dhe

nuk i paraqet këto kërcënime apo shantazhe tek institucionet relevante, atëherë si mund të besojnë qytetarët për t’i paraqitur këto raste, nëse kanë të ngjashme”, thotë Demhasaj.

Ai shton se, menjëherë pas deklaratës së presidentes Osmani, përmes së cilës ajo ka pretenduar se i janë bërë kërcënime dhe presion, Prokuroria është dashur ta intervistojë atë. Sipas tij, presidentja duhet t’ia japë Prokurorisë emrat e personave që i kanë bërë presion ose e kanë kërcënuar. “Në këtë rast, mendoj se Prokuroria duhet të fillojë dy hetime: hetimet se kush janë kërcënuesit apo shantazhuesit e presidentes, në anën tjetër edhe një [hetim] ndaj presidentes, e cila, thjesht, nuk po i paraqet kryesit potencialë të veprës penale në këtë rast”, thotë Demhasaj.

Më 17 tetor Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), në një reagim lidhur me mosdekretimin e të propozuarit për Kryeprokuror të Shtetit nga ana e presidentes Osmani, komentoi edhe pretendimet e saj për presione dhe kërcënime. KPK-ja e ftoi Osmanin që “nëse ka prova dhe dëshmi, t’i dërgojë ato tek organet kompetente, në mënyrë që të ndriçohen plotësisht”.

Mbahet konferenca e sigurisë kibernetike "DefendX23", bëhet thirrje të mbrohen të dhënat personale

PRISHINË, 24 TETOR - Në hapësirat e Innovation Centre Kosovo është mbajtur konferenca vjetore e sigurisë kibernetike "DefendX23", në të cilën është diskutuar për ballafaqimin me rreziqet kibernetike dhe fuqizimit të bizneseve.

Komisionarja e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva-Dërmaku, ka thënë se po vazhdojnë të përballen me ankesa sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale. Në fjalimin e saj, ajo ftoi bizneset të angazhojnë një zyrtar për ruajtjen e të dhënave personale të punëtorëve. "Kemi arritur të krijojmë standardet tona duke u bazuar në standardet e vendeve

evropiane për secilën fushë. Po përballemi me ankesa të natyrës së rëndë, por duhet ekspertiza jonë, por edhe ekspertiza e vendeve të tjera evropiane. Me keqardhje them se ndërgjegjësimi për mbrojtjen e të dhënave personale është në nivel të ulët", është shprehur ajo.

Më tutje, ajo ka thënë se tashmë bizneset kanë filluar të kenë më shumë njohuri sa i përket sigurisë kibernetike. "Kërkoj prej jush që ta keni një zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale, qoftë edhe nëse keni dy punëtorë. Sektori privat dhe sektori publik e kanë detyrë t'i mbrojnë të dhënat personale", ka thënë Sogojeva-Dërmaku.

Komisionarja bëri thirrje që gjatë zhvillimit të aplikacioneve, bizneset të kenë kujdes për mbrojtjen e të dhënave personale. "Bëj thirrje që gjatë zhvillimit të aplikacionit të ndërmermi masat e sigurisë. Mos mblidhni më shumë të dhëna personale sesa ato që duhen. Mundësia e mbrojtjes e të dhënave personale nga kompania mbron qytetarin dhe bashkërisht zhvillojmë shoqërinë tonë, dhe mund të afrohem me shoqëritë evropiane. Jemi të gatshëm të ofrojmë këshilla", potencoi ajo.

Hafize Bajrami nga Ministria e Mbrojtjes ka thënë se gjatë vitit 2023 kanë themeluar Qendrën Shtetërore

Trajnuese për Siguri Kibernetike. Ajo ka thënë se në vitet e kaluar në Ministrinë e Mbrojtjes është diskutuar shumë pak për sigurinë kibernetike. "Siguria kibernetike është diskutuar vetëm në kuadër të IT-së, pastaj kanë filluar bashkëpunimin me Iowan për ngritjen e kapaciteteve kibernetike 'Ngritja e Njesisë për Siguri Kibernetike në FSK' në vitin 2019. Pastaj në vitin 2023 është bërë Qendra Shtetërore Trajnuese për Siguri Kibernetike 2023", u shpreh ajo.

Bajrami ka thënë se misioni i Njesisë për Siguri Kibernetike operon dhe siguron rrjetet e Ministrisë së

Mbrojtjes dhe FSK-së. "Mundëson lirinë e manovrimit të FSK-së në hapësirën kibernetike". Më tej, ajo tha se bëjnë trajnime të vazhdueshme për stafin lidhur me sigurinë kibernetike. "Siguria kibernetike është një problem global që duhet të adresohet globalisht nga të gjitha qeveritë së bashku", ka theksuar ajo.

"DefendX" është një konferencë vjetore e sigurisë kibernetike, e përkushtuar për promovimin dhe zbatimin e praktikave më të mira të mbrojtjes së informacionit. Tema që do të trajtohet këtë vit është "Ballafaqimi me rreziqet kibernetike dhe fuqizimi i biznesit".



'Kurti, para se të shkojë në Greqi, është dashur të raportojë në Kuvend për ultimatumin e pesësjes'



PRISHINË, 24 TETOR - Zëdhënësja e LDK-së, Sibel Halimi, ka thënë se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, do të duhej të raportonte në Kuvendin e Kosovës për ultimatumin që ka marrë nga pesë emisarët të shtunën para se të shkojë në Greqi për të ligjësuar për probleme globale. "Kryeministri do të duhej të raportonte në Kuvend për ultimatumin që ka marrë nga pesësja që përfaqësojnë aleatët strategjik të

Kosovës, para se të ligjërojë nga Greqia për trazirat në Evropë e problemet në të katër anët e botës. Shumë popullist në mitingje zgjedhore e njeri i prapaskenës në veprime, kryeministri ka përbrendësuar një qasje mosbesuese kundruall opozitës, medias e miqve të Kosovës dhe çka është më e frikshme, ai ka hyrë në ujëra të turbullta me politika konfliktuozë", ka shkruar ajo në "Facebook".

Halimi ka thënë se Kuvendi, në anën tjetër, jo vetëm që nuk e kryen detyrën e vet, por shpesh abuzon me të drejtën e deputetëve të shumicës që lirshëm të deklarohen. "Tempulli i demokracisë nuk është zgjatim i ekzekutivit; i pari e mbikëqyr dhe kontrollon këtë të dytin. Ky deformim, kjo shtërkëqje e konstitucionalizmit shtetëror, është rrezik shtesë për Republikën tonë!", ka shkruar Halimi.

Prokuroria e Shtetit deri më tash nuk ka dhënë ndonjë përgjigje nëse po e trajton edhe çështjen e mosdenoncimit të presioneve dhe kërcënimeve të pretenduara nga presidentja Osmani.

Në të kaluarën sistemi i drejtësisë në Kosovë është kritikuar shpesh, qoftë për korrupsion, qoftë për ekspozimin ndaj ndërhyrjeve politike.

Gjatë konferencës për medie më 17

tetor, Osmani renditi disa shkelje ligjore, që tha se janë gjetur në procesin e përzgjedhjes së kryeprokurorit, prandaj ajo ka marrë vendim që të mos e dekretojë atë. Sipas Osmanit, disa nga shkeljet që janë evidentuar nga Presidenca për procedurën e përzgjedhjes së kryeprokurorit janë: Shmangia nga zbatimi i kriterëve ligjore në përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit; Mohimi i

mundësisë për mjet ankimor efektiv brenda KPK-së për kandidatët e pakënaqur përmes propozimit arbitrar të raportit të komisionit për rishqyrtim të kundërshtimeve; Shkelje në procedurat e vlerësimit të reputacionit profesional të kandidatëve; Shkelje në procedurat e vlerësimit të integritetit të kandidatëve; Shkelje në procedurat e vlerësimit të koncept-dokumentit

dhe prezantimit të tij nga kandidatët; Cenimi i parimit të transparencës gjatë procedurave të përzgjedhjes; Cenimi i parimit të barazisë përgjatë procedurës së përzgjedhjes së Kryeprokurorit; Cenimi i parimit të meritokracisë përgjatë procedurave të përzgjedhjes; Mungesat në dokumentacionin e dorëzuar nga KPK përkundër kërkesave të Presidencës që ta plotësojë atë.

Në garë për postin e Kryeprokurorit të Shtetit, përveç Blerim Isufaj, kanë qenë edhe Armend Hamiti, Lulzim Sylejmani, Shqipdon Fazliu dhe Kujtim Munishi.

Kryeprokurorit të deritashëm të Shtetit, Aleksandër Lumezi, i ka skaduar mandati më 21 prill 2022. Aktualisht ushtrues i detyrës është Besim Kelmendi, i cili i ka kompetencat e plota të Kryeprokurorit të Shtetit.

Spitali i Prizrenit dhe ai i Gjilanit përfitojnë grante nga Japonia

PRISHTINË, 24 TETOR - Në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës është mbajtur të martën ceremonia e nënshkrimit të dy projekteve në kuadër të grantit të ndihmës japoneze për projektet bazë të sigurisë njerëzore (GGP) për vitin fiskal 2023 në praninë e ministrit të Shëndetësisë, Arben Vitia, Keisuke Yamanaka, të ngarkuar me Punë të Përkohshme të Ambasadës së Japonisë në Kosovë dhe drejtorit të përgjithshëm të ShSKUK-së, Elvir Azizi. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka falënderuar shtetin e Japonisë për grantin, duke e vlerësuar shumë të nevojshëm për dy spitalet e përgjithshme, atë të Prizrenit dhe të Gjilanit.

Ai ka vlerësuar ndihmat e vazhdueshme që po jep shteti i Japonisë për Kosovën, duke shprehur se pajisjet që do të sigurohen do të shërbejnë për trajtim më të mirë për pacientët e këtyre dy rajoneve që mbulojnë numër të madh të banorëve. Falënderues për grantin e shtetit japonez u shpreh edhe drejtori i ShSKUK-së, Elvir Azizi, i cili, pasi e ka falënderuar të ngarkuarin me punë të Ambasadës së Japonisë lidhur me grantin, ka theksuar se përdorimi pajisjeve do të sigurojë shëndet më të mirë për qytetarët. Kontratat e grantit u nënshkruan nga Keisuke Yamanaka, i ngarkuar me Punë të Përkohshme të Ambasadës së Japonisë në Kosovë dhe përfaqësuesit e dy spitaleve të



përgjithshme, dr. Arsim Emini, drejtor ekzekutiv i Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe dr.

Narqize Arëlniu-Hoxhaj, drejtoreshë ekzekutive e Spitalit të Përgjithshëm të Prizrenit.

Në fjalën e tij, Yamanaka ka theksuar se shëndetësia është element themelor i shoqërisë dhe Japonia do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në përpjekjet e saj për ta përmirësuar shërbimin shëndetësor për qytetarët e saj. Vlera totale e projektit është 66 710 euro.

Projekti për Sigurimin e Pajisjeve të Fizioterapisë për Spitalin e Përgjithshëm të Prizrenit synon përmirësimin e shërbimeve mjekësore të ofruara nga Spitali i Përgjithshëm i Prizrenit përmes ofrimit të kompletit të pajisjeve të fizioterapisë siç janë pajisjet e terapisë me ultratinguj. Përfituesit e prishëm janë rreth 3 000 pacientë në vit. Vlera totale e projektit është 45 264 euro.

Zllatan Ellek, kryetar i ri i Listës Serbe

PRISHTINË, 24 TETOR - Zllatan Ellek është zgjedhur njëzëri kryetar i ri i Listës Serbe në Kosovë. Ellek është ushtrues detyre i drejtorit të Qendrës Spitalore Klinike në Mitrovicën e Veriut. Ai u zgjodh gjatë një votimi të hapur në seancën e Kuvendit të Listës Serbe të mbajtur të martën në Mitrovicën e Veriut, ku Lista Serbe zgjodhi edhe kryesinë e re. Lider i Listës Serbe deri më tani ishte Goran Rakiq. Lista Serbe është partia më e madhe e serbëve në Kosovë e cila ka mbështetjen e Beogradit. Këto ndryshime në leadershipin e partisë po bëhen pas ngjarjeve në Banjskë afër Zveçanit në veri të Kosovës më 24 shtator, kur një grup i armatosur serb sulmoi policinë e Kosovës dhe vrau rreshterin Afrim Bunjaku. Në shkëmbimin e zjarrit që pasoi, u vranë edhe tre sulmues serbë. Pesë ditë më vonë nënkryetari i atëhershëm i Listës Serbe, Millan Radoiqiq, mori përgjegjësinë për këtë sulm dhe dha dorëheqje nga ajo pozitë. Ai është duke u hetuar si në Kosovë ashtu edhe në Serbi. Këto ndryshime pasojnë gatishmërinë e Listës Serbe, të shprehur më 13 tetor, për të marrë pjesë në zgjedhje nën organizimin e institucioneve të Kosovës në komunat në veri, pasi i kishte bojkotuar ato në prill të vitit 2023. Në atë kohë në katër komuna në veri, Mitrovicë



e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq, ishin zgjedhur kryetarë shqiptarë. Zgjedhjet e prillit u mbajtën pas tërheqjes kolektive të zyrtarëve serbë nga institucionet lokale dhe qendrore në nëntor të vitit 2022 për shkak të pakënaqësive me një vendim të Qeverisë së Kosovës që kishte të bënte me reregjistrimin e targave ilegale serbe në ato RKS-Republika e Kosovës. Miodrag Marinković nga organizata joqeveritare Qendra për Veprime Afirmative Sociale beson se personat e rinj në Listën Serbe nuk do të thonë "praktikisht asgjë" dhe beson se

kjo parti me siguri do të mbetet me ndikim për shkak të mbështetjes së Beogradit. "Këtë mund ta shohim nga qeverisja e Partisë Progresive Serbe në Serbi, në të cilën njerëzit drejtues në parti zëvendësohen, sepse janë diskredituar nga një sërë aferash. Mendoj se po kjo po i ndodh Listës Serbe. Është vetëm një tentativë 'ribrendimi', por jo një ndryshim thelbësor", shprehet ai. Edhe politikani serb nga Graçanica, Branimir Stojanović, beson se çdo ndryshim brenda Listës Serbe do të jetë formal, gjegjësisht nuk do të sjellë "ndryshime thelbësore".

"Prandaj është e rëndësishme që populli ynë të kuptojë se mjaft është me këtë formalitet... besoj se njerëzit tanë do ta vlerësojnë shumë mirë se të gjitha ndryshimet që do të ndodhin, janë thjesht 'larje' e një mekanizmi korruptiv, që është vështirë të ndryshohet", tha Stojanović në një deklaratë për REL-in. Stojanović dhe aktivisti politik nga veriu i Kosovës, Millija Bishevac, po formojnë një parti të re që do të jetë "alternativë e Listës Serbe". Bëhet fjalë për partinë Lëvizja Popullore Serbe, e cila, sipas Stojanovićit, do të veprojë dhe do t'i "përfaqësojë

interesat e serbëve në të gjitha mjediset e banuara me shumicë serbe në Kosovë".

Kush është Zllatan Ellek?


Në maj të vitit 2020 Qeveria e Serbisë emëroi Zllatan Ellekun ushtrues detyre të drejtorit të Qendrës Spitalore Klinike në Mitrovicën e Veriut. Ky institucion, sikurse institucionet e tjera shëndetësore në mjediset e banuara me serbë në Kosovë, punon në sistemin serb. Ndërkohë, Elleku mori pjesë në tubimet e organizuara nga Lista Serbe, duke përfshirë edhe atë të 6 nëntorit 2022, një ditë pas largimit të serbëve nga institucionet e Kosovës në veri. Ai më pas në fjalimin e tij tha se "ne mbijetua falë mbështetjes së leadershipit tonë, në radhë të parë presidentit Aleksandar Vuçiq". Së fundmi ai ka theksuar se për shkak të "terrorit të Kurtit", institucionet shëndetësore në zonat serbe në Kosovë po kërcënohen nga "katastrofa humanitare". Ai ka thënë se autoritetet e Kosovës nuk lejojnë importin e barnave dhe materialeve mjekësore, gjë që Ministria e Shëndetësisë e Kosovës e ka mohuar.

Policia arreston tre persona të dyshuar në rastin "Fajdeja"

PRISHTINË, 24 TETOR - Sektori i Hetimeve të Krimeve të Rënda në kuadër të Drejtorisë për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda të PK-së, në vazhdimin e hetimit të rastit "Fajdeja", të martën ka zbatuar urdhëresën e lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj për kontrollin e shtëpive dhe

objekteve përcjellëse në pesë lokacione të cilat përfshijnë regionin e Prishtinës dhe një në regionin e Mitrovicës. Gjatë realizimit të operacionit policor dhe kontrollit janë arrestuar tre persona të dyshuar dhe janë konfiskuar në cilësi të provave materiale: pesë vetura, tre telefona celularë, një lloptop, dy USB

dhe disa dokumente të shkruara me dorë. Me aktvendim mbi ndalimin e personit të arrestuar, të lëshuar nga prokurori i rastit, pasi të përfundohen të gjitha procedurat, personat e dyshuar do të dërgohen në qendrën e mbajtjes për 48 orë për procedura të mëtejme.



Vetëm mendjet e çoroditura prodhojnë konflikt me realitetin: Kosova si rast



Milazim KRASNIQI

1. Kosova është e proklamuar si shtet multientik dhe ka mbikëqyrje civile e ushtarake të huaj. Prandaj me statusin e saj specifik që e ka, nuk mund të funksionojë si shtet mirëfilli kombëtar, përkundër ideve dhe ndjenjave tona kombëtare. Por, kjo gjendje duale nuk ka pse e bën Kosovën më pak të dashur për shqiptarët e saj dhe për shqiptarët në përgjithësi. Kosova si shoqëri është dhe do të mbetet shqiptare, por si shtet me obligime ndërkombëtare ndaj pakicave, veçmas ndaj pakicës serbe. Ky realitet nuk ndryshon nëse ne e imagjinojmë një realitet tjetër. Ky realitet mund të ndryshojë nëse ne arrijmë ta bëjmë Kosovën një shtet të suksesshëm, të integruar në NATO dhe në BE, ku pastaj edhe funksionalisht bëhet pjesë përbërëse e botës shqiptare-atlantike.

2. Marrëveshja Ushtarake-Teknike e firmosur ndërmjet NATO- dhe RFJ-së ka larguar të gjitha forcat serbe nga territori i Kosovës. Deri sa të jetë në fuqi ajo marrëveshje, forcat serbe nuk mund të kthehen në Kosovë. Logjikisht, ajo marrëveshje mund

të rishikohet, vetëm pasi të jetë arritur një marrëveshje përfundimtare politike e mishëruar edhe në një rezolutë të re të KS të OKB-së. Nëse Marrëveshja Ushtarake-Teknike do të suspendohej njëanshëm nga NATO, gjendja e luftës në Kosovë do të rikthehej në atë çast. Rrjedhimisht, politika shtetërore në Kosovë, duhet ta ketë gjithmonë para sysh partneritetin strategjik me NATO-n e veçmas me SHBA-në. Ndryshimi eventual anti atlantik i politikës shtetërore në Kosovë, mund të ketë pasoja fatale.

3. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit ka legjitimuar prezencën ushtarake e civile ndërkombëtare në Kosovë. Deri sa të jetë në fuqi kjo rezolutë, prezenca civile dhe ushtarake ndërkombëtare në Kosovë është e pashmangshme, me të gjitha konsekuencat që kjo nënkupton. Pra edhe ato negative. Por ky është realiteti. Asnjë politikë shtetërore normale nuk duhet të krijojë disponim anti OKB në Kosovë.

4. Bashkimi Evropian është i mandatuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-s për ta

ndërmjetësuar dialogun ndërmjet Kosovës e Serbisë. Gjasat janë se deri sa të arrihet një marrëveshje përfundimtare, mandati i Bashkimit Evropian do të mbetet në fuqi. Prandaj në çdo rast, fushatat kundër zyrtarëve të Bashkimit Evropian, janë në dëm të Kosovës.

5. Opinioni i Gjykatës së Drejtësisë mbi pavarësinë e Kosovës, është i favorshëm, por nuk është obligativ. Si i tillë duhet të afirmohet sa më shumë, por të mos mbahemi pas tij si pianeci për gardhi.

6. Plani i Përgjithshëm i Marti Ahtisarit nuk është miratuar nga Këshilli i Sigurimit, prandaj nuk prodhon obligime për shtete që nuk duan ta njohin pavarësinë e Kosovës. Duhet të kërkohen rrugë të tjera për të ndryshuar qëndrimin e shteteve që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës, veçmas atyre të Bashkimit Evropian.

7. Deklarata e Pavarësisë e 17 shkurtit 2008 është në themel të pavarësisë dhe duhet të mbetet e tillë në çdo rast. Por, duke u begatuar me shndërrimin e Kosovës, nga brenda, në shtet të

suksesshëm.

8. Meqë kjo kornizë nuk mund të ndryshohet në mënyrë të njëanshme nga qeveritë e Kosovës, duhet të hartohen politika qeveritare e shtetërore realiste e kurrsesi konformtuese me faktorët që kanë mandat legal në Kosovë (NATO, OKB, BE.) Politikat realiste kërkojnë konsensus të brendshëm politik e shoqëror, e jo harxhim të energjive në luftëra të brendshme politike e shoqërore, siç ka ndodhë në dy decaeniet e kaluara. Harxhimi i energjive në luftëra të brendshme i konvenon Serbisë dhe aleatëve të saj, që duan ta paraqesin Kosovës si shtet të dështuar dhe ta rifusin në ndonjë proces tjetër të ridefinimit të statusit. Konfrotimet e brendshme, ndër të tjera, e kanë faktorizuar Listën Serbe, deri në pikën sa u shndërrua në agjent haptazi antishtetëror.

9. Kosova duhet të kërkojë një aranzhman separat me NATO-n, ndoshta në versionin që e ka Islanda me NATO-n, pa e cenuar mandatin e KFOR-it, po vetëm si aranzhman komplementar.

10. Qytetarët e Kosovës duhet të vetëdijesohen se jetojnë në një

shtet i cili në konstelacionin e tashëm gjeopolitik e gjeostrategjik e ka të pamundur të anëtarësohet në OKB. Ata duhet të investojnë në suksesin e këtij shteti, e jo ta minojnë e as të ikin nga sytë këmbët, sepse në atë rast dështimi i Kosovës bëhet më potencial.

11. Gjatë këtyre viteve të prezencës ndërkombëtare, nën presionin neokolonialist dhe islamofobik, Kosova kulturalisht është deshqiptarizuar dhe deislamizuar në masë të rrezikshme. Shoqëria shqiptare në Kosovë duhet të rikthehet në ekuilibrat e vet kombëtarë e fetarë. Me eksperimente neokolonialiste, nuk bëhet shoqëri funksionale dhe konkurruese. Në fakt, nëse kjo shoqëri deshqiptarizohet dhe deislamizohet edhe më shumë, pashmangshëm do të rikthehej në një proces të ri të ridefinimit të identitetit të saj, ku karta kryesore do të ishte riserbizimi i saj. Vetëm mendjet e çoroditura nuk e kanë para sysh faktin që narrativa ortodokse serbe mbi Kosovën është gjithnjë aktive dhe shumë virulente.

Ministrja Hajdari dënohet me 200 euro gjobë për aksidentin në Prishtinë

PRISHTINË, 24 TETOR - Gjykata Themelore e Prishtinës e ka dënuar ministren e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, me 200 euro gjobë për rastin e aksidentit në të cilin e kishte goditur një vajzë të mitur me veturë. Aksidenti kishte ndodhur më 10 prill të vitit të kaluar. Hajdari është dënuar me

dënim me gjobë në shumën prej 200 eurosh.

“Gjykata duke vendosur ne bazë të neneve 3, 7, 8, 9, 17 paragrafi 1 pika 1.2, 1.5.31 dhe te nenit 35 të Ligjit për Kundërvajtje me nr. 05/L-087, të pandehurës R. H. i shqipton dënim me gjobë në shumën prej dyqind euro (200), obligohet e pandehura që

gjobën e shqiptuar të paguajë në afat prej 15 dite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi”, thuhet në njoftimin që e ka bërë Gjykata e Prishtinës.

Kundër këtij aktgjykimi, të cilin e ka nxjerrë gjyqtari për kundërvajtje, Shaqir Mazreku, palët kanë të drejtë ankese në Gjykatë e Panelit.



Asetet e bankave komerciale në Kosovë në muajin shtator kanë shënuar rritje 67.6 milionë euro

Mbi 7 miliardë euro janë asetet e bankave komerciale në Republikën e Kosovës dhe investimet e tyre jashtë vendit janë rritur për 43.2 milionë euro krahasuar me muajin gusht 2023. Kështu thuhet në statistikat bankare për muajin shtator 2023, të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK), duke shtuar se vlera e kredive bruto ka arritur në 4.79 miliardë euro, derisa shuma e depozitave të klientëve është 5.89 miliardë euro

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 TETOR - Asetet e bankave komerciale në muajin shtator 2023 kanë shënuar rritje rreth 67.6 milionë euro krahasuar me muajin paraprak. Në shtator 2023 vlera e asetëve të bankave komerciale ishte 7.16 miliardë euro. Kështu thuhet në statistikat bankare për muajin shtator 2023, të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Investimet e bankave komerciale jashtë vendit (në formë të depozitave, letrave me vlerë dhe plasmanëve të tjera) kanë shënuar rritje rreth 43.2 milionë euro krahasuar me muajin

paraprak.

Ndërkaq vlera e kredive bruto në fund të muajit shtator 2023 ishte 4.79 miliardë euro, e që paraqet një rritje prej 61.53 milionë eurosh krahasuar me muajin paraprak. "Depozitat e klientëve në shtator 2023 kanë shënuar rritje rreth 14.63 milionë euro krahasuar me muajin paraprak. Vlera e depozitave në shtator 2023 arriti vlerën 5.89 miliardë euro. Rreth 25 % e depozitave janë të afatizuara. Ekonomitë familjare dominojnë me rreth 66.5 % të totalit të depozitave (apo rreth 3.88 miliardë euro)", theksohet në këtë raport të BQK-së. Raporti kredi-depozita në muajin shtator ishte në nivelin 81.9 %. Gjithsej kapitali i bankave



komerciale në fund të muajit shtator 2023 ishte 821.3 milionë euro. Norma mesatare e interesit në depozita në muajin shtator ishte 2.43 % (në gusht ka qenë 2.52 %).

Norma mesatare e interesit në kredi në muajin shtator ishte 6.51 % (në gusht ka qenë 6.70 %). Margjina e normës së interesit në kredi dhe depozita në muajin shtator ishte 4.08 % (në gusht

ishte 4.18 %).

Vlera e kredive të reja në muajin shtator ishte 166.6 milionë euro. Ndërsa vlera e depozitave të reja në muajin shtator ishte 87.02 milionë euro.

Lansohet projekti që synon eliminimin e parregullsive rreth asistencës sociale

PRISHTINË, 24 TETOR - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), në bashkëpunim me Bankën Botërore, kanë zbatuar Projektin për Reformën e Sistemit të Asistencës Sociale (SAS) të Kosovës. Ky projekt mundëson identifikimin e saktë të familjeve që kualifikohen për asistencë sociale dhe ka për qëllim ta luftojë varfërinë e përhershme. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se si qeveri janë duke mbushur premtimet e dhëna për përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Me këtë projekt Murati ka thënë se synim do të jetë edhe aktivizimi i anëtarëve të familjeve përfituese në tregun e punës. "Projekti për Reformën e Skemës të Asistencës Sociale do të zbatohet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe ka për qëllim ta zgjerojë skemën e asistencës



sociale në Kosovë, t'i eliminojë parregullsitë dhe të garantojë që të gjitha familjet në nevojë të

ndiejnë dorën e shtetit. Përmes këtij projekti Ministria e Financave synon ta largojë

diskriminimin brenda kategorive duke e bërë sistemin e asistencës sociale të atillë që në njërin anë e

lufton varfërinë, në anën tjetër nuk krijon varësi të përhershme për familjet", ka thënë Murati.

Ai ka shtuar se përmes bashkëpunimit me Bankën Botërore synojnë të krijojnë edhe mundësi të qëndrueshëm punësimi të përfituesit duke e bërë të lehtë kalimin e tyre nga përfitues të skemës së asistencës sociale në punësim të rregullt dhe të qëndrueshëm. "Vlen të theksohet se ky është një angazhim konkret për përmbushjen e programimit tonë qeverisës si dhe zbatimit të masës 3.3 të ringjalljes ekonomike", është shprehur ministri Murati.

Edhe drejtori për Kosovë i Bankës Botërore, Massimiliano Paolucci, u shpreh i lumtur që po arrijnë të zbatojnë një projekt të tillë. Paolucci ka theksuar se si Bankë Botërore janë të gatshëm të vazhdojnë ta mbështetnin këtë agjendë të rëndësishme në Kosovë.

Mbahet mbledhja e qeverisë, ndahen 1.6 milion euro për Trepçën

PRISHTINË, 24 TETOR - Qeveria e Kosovës ka zhvilluar mbledhjen e radhës në mënyrë elektronike, në të

cilën ka shqyrtuar dhe miratuar ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të qeverisë nr. 20/165 për

emërimin e komisionit për dhënie të provimit të Jurisprudencës si dhe vendimin për ndarjen e

mjeteve buxhetore në shumën prej 1,675,150 eurosh për ndërmarrjen publike "Trepça Sh. A."



SHBA gëndron në prag të një lufte globale



Robert CLARK

Lufta midis Izraelit dhe Hamasit do të intensifikohet, me një pushtim tokësor të Gazës që besohet të ndodhë së afërmi. Forcat izraelite po mblidhen përgjatë kufirit dhe ministri i mbrojtjes Yoav Gallant u ka thënë trupave në pritje, se së shpejti do ta shohin Gazën “nga brenda. Komanda do të vijë”. Kjo komandë mund të jetë goditja e parë në një konflikt shumë më të gjerë. Në detin Mesdhe, një grup sulmi ajror amerikan është në pritje, duke shpresuar të pengojë aktorët e tjerë rajonalë nga përpjekjet për të ndërhyrë në luftën midis Izraelit dhe Hamasit. Një grup i dytë është drejtuar në Gjirin Persik, së bashku me sistemet e mbrojtjes raketore. Predhat e artilerisë të cilat më parë ishin drejtuar në Ukrainë, tashmë janë rezervuar për Izraelin. Ndërkohë, në kufirin verior të Izraelit, shkëmbimet e zjarrit me grupin terrorist Hezbollah të financuar nga Irani po shtohen. Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ka paralajmëruar se konflikti i

drejtpërdrejtë do të sillte “shkatërrim të paimagjueshëm” për Libanin dhe Hezbollahun. Bota po përgatitet për luftë. Konflikti tashmë është ndezur në Evropë, me forcat ruse dhe ukrainase të mbërthyer në ofensivë dhe kundërsulm. Pas sulmit terrorist të Hamasit ndaj Izraelit, tani mund të ndizet Lindja e Mesme. Ndodh apo jo, kjo varet pjesërisht nga Irani, financuesi dhe tutori politik i Hamasit dhe Hezbollahut, i cili tani është disa çaste larg zhytjes së mundshme të botës në një luftë të tretë botërore. Ministri i Jashtëm iranian ka paralajmëruar Izraelin se nëse lufta nuk ndalet “menjëherë”, atëherë “çdo gjë është e mundur, në çdo moment, dhe rajoni do të dalë jashtë kontrollit”. Sekretari amerikan i mbrojtjes Lloyd Austin ka paralajmëruar për një rrezik shumë real të “përshkallëzimit të ndjeshëm”, të sulmeve ndaj forcave amerikane dhe civilëve. Ai ka arsye të forta për t’u shqetësuar. Teherani nuk po e kufizon armiqësinë vetëm me fjalë; përfaqësuesit e tij rajonalë

duken të vendosur të ngatërrojnë më tej SHBA-në, duke sulmuar forcat amerikane me dronë dhe raketa në bazën ajrore Ain Al-Asad në Irak, dhe al-Tanf në Siri. Irani nuk po sprapsset. Tashmë, një luftanije amerikane ka rrëzuar tre raketa lundruese të lëshuara nga terroristët Houthi, që mbështeten nga Irani në Jemen. Duke u nisur drejt veriut, këto raketa potencialisht synonin Izraelin. Nëse do ishte i suksesshëm, një sulm i tillë do të kishte pasojë të gjera për Iranin, me hakmarrje pothuajse të sigurt izraelite, që mund të shkaktojë një luftë të drejtpërdrejtë – dhe përfshirjen e SHBA. Situata është tej mase e tensionuar. Edhe pse angazhimi i tij ndaj luftës së Ukrainës fillon të lëkundet, Perëndimi përsëri e gjen veten të sfiduar nga regjimet autoritare. Burimet në dispozicion për Izraelin nuk janë të pakufizuara. Përveç vazhdimit të furnizimit me armë në Ukrainë, Amerika duhet të shqetësohet edhe për krahun e saj në Paqësor. Uashingtoni është i angazhuar

me riorganizimin e shpejtë të ushtrisë së vet për t’u përballur me kërcënimin e paraqitur nga një regjim komunist kinez gjithnjë e më luftarak, që synon ribashkimin me Tajvanin, edhe me forcë nëse është e nevojshme. Me luftën dhe konkurrencën e fuqive të mëdha që po shpërthejnë në Evropë, dhe SHBA-të gjithnjë e më shumë të përfshira në Lindjen e Mesme, regjimi komunist në Pekin mund ta shohë këtë si një mundësi që shfaqet një herë në disa breza. Me vëmendjen e Amerikës të shpërndarë, Irani mund të vendosë të provokojë më tej SHBA-në, në përpjekjet e veta për të shpallur dominimin rajonal, duke u përpjekur t’i shtyjë amerikanët të shkëputen dhe ta lënë Izraelin vetëm. Nuk është e vështirë të shihet se si një akt armiqësor i gjykuar keqas, të mund të shkaktojë një reagim ushtarak dhe situata në Lindjen e Mesme të fillojë të dalë jashtë kontrollit të çdo lideri, të tërheqë në Uashingtonin dhe t’i japë Kinës dritaren e dëshiruar, për të tentuar një goditje vrasëse në Tajvan – një goditje e cila,

pothuajse në mënyrë të pashmangshme do të tërhiqte një reagim amerikan. Brenda disa muajsh, SHBA mund të përfshihet drejtpërdrejt në dy luftëra shkatërruese, në dy kontinente, dhe duke financuar një të tretë në Ukrainë. Ky makth nuk është i pashmangshëm. Rruga drejt përshkallëzimit është e shtruar me qëllime të mira dhe zbutje. Nëse Amerika dhe Perëndimi tregojnë vendosmëri, se do të luftojnë në përgjigje të provokimit, ata ende mund të përballen me torturuesit e tyre potencialë. Deri më tani, Uashingtoni dhe aleatët e tij kanë qenë të palëkundur në mbështetjen e tyre për Izraelin dhe Kievin. Ata nuk duhet të lëkundin në javët në vazhdim. Diktatorët dhe të fortët respektojnë vetëm forcën, dhe është forca dhe vendosmëria që do ta detyrojnë Teheranin të tërhiqet. Siç thotë një fjalë e vjetër, nëse do të kesh paqe, përgatitu për luftë. Robert Clark është drejtor i mbrojtjes dhe sigurisë në Civitas. Më parë, ai ka shërbyer në Ushtrinë Britanike

Simbolika e Feniksit: Ripërtëritja, rilindja dhe shkatërrimi



Legjenda antike na prezanton pamjen e një zogu magjik, rrezatues që jeton qindra vjet e pastaj rilind nga hiri, për të nisur një jetë të re, po aq të gjatë. Aq e fuqishme është simbolika e tij, sa që është motiv dhe imazh që ende përdoret në kulturën dhe folklorin popullor. Ky është Feniksi madhështor ...

Nga: Liz LEAFLOOR

Feniksi legjendar është zog i madh, pak a shumë si një shqiponjë, me ngjyra të forta në të kuqe, vjollcë dhe të verdhë, pasi lidhet me lindjen e Diellit dhe zjarrit. Sytë e tij janë të kaltër dhe ato shkëlqejnë si gurët safirë. Ai e ndërton vetë vendin e funeralit të tij dhe e ndez atë me një përplasje të vetme të flatrave. Pas vdekjes, ky zog rilind në mënyrë të lavdishme nga hiri dhe fluturon më tutje. Feniksi pra simbolizon ripërtëritjen dhe ringjalljen, dhe është përdorur për të përfaqësuar shumë tema si Dielli, koha, ringjallja, shenjtërimi, një perandori, metempsikozat, Parajsën, Krishtin, Marinë, virgjërinë dhe njerëzit e

jashtëzakonshëm.

Tina Garnett shkruan në librin e saj se "në mitologjinë egiptiane, arabe dhe greke të zotit jetëgjatë, kur ndien se po i afron fundit, Feniksi ndërton një fole me bimët më të mira aromatike, më pas u vë atyre flakën dhe shkrumbohet prej tyre. Nga grumbulli i hirit lind pastaj një Feniks i ri dhe i fuqishëm. Pastaj e balsamos hirin e paraardhësit të tij në një vezë dhe fluturon për në qytetin e Diellit, Heliopolis, ku e depoziton vezën në altarin e Zotit të Diellit". Ndërkohë, ekzistojnë versione më pak të njohura të këtij miti në të cilin Feniksi vdes dhe dekompozohet para rilindjes së tij. Grekët e quanin Feniks, por nga egiptianët e lashtë quhej Benu, nga indianët e Amerikës Zogu Rrufe, nga rusët Zogu i

Zjarrit, nga kinezët Feng Huang dhe nga japonezët Hō-o.

Besohet se grekët i quanin kananejtë fenikasë, që mund të rrjedhë nga fjala greke Feniks, që do të thotë e purpurt. Në fakt, simbolgjia e Feniksit është gjithashtu e lidhur ngushtë me Fenikasit. Në shembullin ndoshta më të hershëm të legjendës, egiptianët e përshkruanin Benu, si pjesë të mitit të tyre të krijimit. Ai jetonte në majë të shkëmbinjve apo obelisqeve ben-ben dhe adhurohej së bashku me zotat Osiris dhe Ra. Benu shihet si një avatar i Osirisit, si një simbol i gjallë i hyjnisë. Zogu diellor shfaqet në hajmalitë e lashta si një simbol i rilindjes dhe pavdekësisë, dhe lidhej me periudhën e përmbytjeve të Nilit, duke sjellë pasuri dhe pjellori të re.

Historiani grek Herodoti, shkruan se priftërinjtë e Heliopolisit antik thoshin se zogu jetonte për 500 vjet, para se të ndërtonte dhe ndizte folenë e tij të fundit. Pasardhësit e tij do të ngriheshin dhe do t'i çonin priftërinjtë në altarin e tempullit në Heliopolis. Në Greqinë e lashtë thuhej se zogu nuk konsumon fruta, por temjan dhe mishra aromatike. Në


të njëjtën kohë mblidhte kanellë për folenë e vet, në përgatitje të vdekjes. Në Azi, Feniksi mbretëron mbi të gjithë zogjtë dhe është simboli i perandorshave kineze dhe hirit femëror, ashtu si Diellit dhe jugu. Vështrimi i Feniksit cilësohej si një shenjë e mirë se në fron ishte ngjitur një udhëheqës i mençur dhe se kishte nisur një epokë e re. Ai ishte një përfaqësues i virtyteve kineze: mirësisë, ndjenjës së detyrës, mirësisë dhe besueshmërisë.

Pallatet dhe tempujt ruheshin nga kafshët mbrojtëse prej qeramike, që të gjitha të udhëhequra nga Feniksi. Feniksi mitik përfshihet në shumë fe dhe tregon jetën e përjetshme, shkatërrimin, krijimin dhe fillimet e reja. Për shkak të temave të vdekjes dhe ringjalljes, u përdor gjithashtu si një simbol në Krishterimin e hershëm, si një analogji e vdekjes së Krishtit dhe e ringjalljes së tij tre ditë më vonë. Imazhi i tij u bë një simbol popullor në lapidarët e hershëm të varreve të krishtera. Ai është gjithashtu simbolikë e një zjarri kozmik për të cilin disa besojnë se krijoi botën e cila në fund do t'a konsumojë atë. Në legjendën

hebraike Feniksi njihet si Milkam – një zog besnik dhe i pavdekshëm.

Kur u kthye në Eden, në kohën kur Eva hëngri mollën e ndaluar, ajo i tundoi kafshët e kopshtit me frutat e ndaluara. Zogu Milkam e refuzoi ofertën dhe për besimin e tij iu dhurua një qytet ku do të jetonte thajse përjetësisht në paqe, duke rilindur çdo njëmijë vjet, dhe duke qenë imun ndaj Engjëllit të Vdekjes.

Feniksi është gjithashtu një simbol alkimik. Ai përfaqëson ndryshimet gjatë reagimeve kimike dhe përparimit përmes ngjyrave, vetive të materies, dhe ka të bëjë me progresin e alkemisë në krijimin e Veprës së Madhe, apo gjetjes së Gurit Filozofik. Shtesat moderne të këtij miti në kulturën popullore, thonë se lotët e Feniksit kanë fuqi të mëdha shëruese, dhe nëse Feniksi është afër askush nuk mund të thotë ndonjë gënjeshtër. Duke ndryshuar vazhdimisht, feniksi përfaqëson idenë se fundi është në fakt vetëm fillimi. Ngjashëm me këtë mit të fuqishëm, simboli i Feniksit do të rilindë pa pushim në legjendën dhe imagjinatën njerëzore. /Burimi: *Ancient Origins/Në shqip nga: Bota.all*



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Trepça debuton sot në grupet e FIBA Europe Cup

MITROVICË, 24 TETOR - Klubi i Basketbollit Trepça për herë të parë do të garojë në grupet e FIBA Europe Cup. Mitrovicasit sot (e mërkurë) në orën 19:00 do të përballen me ZZ Leiden nga Holanda.

Ky është takimi i parë për "Xehetarët" në FIBA Europe Cup, pasi javën e kaluar sfida me skuadrën izraelite Hapoel Galil Elion nuk është zhvilluar për shkak të situatës në Izrael. Ndërkohë, holandezët e kanë nisur me

fitore ndeshjen e parë duke mposhtur BCM Gravelines Dunkerque me shifrat 77:69. Atmosfera në Mitrovicë pritet të jetë "elektrizuese" për sfidën evropiane. Mitrovicasit edicionin e kaluar ishin në kualifikime

për grupet e FIBA Europe Cup, por nuk ia arritën qëllimit të hyjnë në grupe, që e arritën këtë vit në Estoni. Fituesit e Kupës dhe Superkupës së Kosovës pritet të kenë paraqitje dinjitoze në garat evropiane.



Futbolli bashkon të rinjtë, familjet, përfaqësuesit institucionalë dhe ndërkombëtarë

PRISHTINË, 24 TETOR - Në partneritet me Olimpiadën Speciale, UNDP dhe UNFPA organizuan një garë të kombinuar futbollit për të rinjtë me aftësi të kufizuara intelektuale dhe fizike që u erdhën nga komuna të ndryshme për ta shënuar Javën e Zhdukjes së Varfërisë.

Ngjarja është mbajtur në fushën e futbollit Rilindja në Taukbaççe në Prishtinë.

112 të rinj dhe anëtarë të familjeve të tyre, me prejardhje të ndryshme etnike nga shtatë komuna, u mblodhën për të luajtur, garuar dhe shoqëruar së bashku.

Ngjarja u organizua me synimin për të kontribuar në rritjen e kohezionit social, gjithëpërfshirjes, besimit dhe fuqizimit të të rinjve me aftësi të kufizuara.

Nisma mbështet një mënyrë jetese të shëndetshme për të rinjtë, duke kundërshtuar gjuhën e urrejtjes dhe normat negative

gjinore. Kjo nismë frymëzuese bashkoi të rinjtë, familjet dhe komunitetet lokale për t'i ndryshuar qëndrimet përçarëse dhe diskriminuese ndaj grupeve më të cenueshme në shoqëri.

Arnild Spence, koordinatore për Zhvillim e OKB-së dhe Igballe Potera, presidente e Olimpiadës Speciale, përshëndetën të pranishmit dhe theksuan rëndësinë e një nisme të tillë për ta mbështetur përfshirjen dhe parimin e mos të lënit askënd pas. Derisa të rinjtë garonin në turne, anëtarët e familjes u mblodhën për të diskutuar mbi sfidat, vështirësitë dhe mundësitë me të cilat përballen këta të rinj në jetën e tyre të përditshme.

Përfundimi i përgjithshëm është se mund të bëhet dhe duhet bërë më shumë për të angazhuar në mënyrë aktive të rinjtë dhe familjet e tyre në të gjitha sferat e jetës.

Nuno Queiros, përfaqësues i përhershëm i UNDP-së, Visare



Mujko Nimani, udhëheqëse e UNFPA-së dhe Marta K. Gazideda, menaxhere e Portofolit të Qeverisjes dhe Ndërtimit të Paqes të UNDP-së, u dorëzuan trofe ekipeve fituese, ndërsa 112

djem e vajza u shpërblyen me medalje për pjesëmarrje dhe angazhim.

Ngjarja shënoi Javën e Zhdukjes së Varfërisë me mesazhin "Dinjteti për të gjithë në praktikë",

si pjesë e iniciativës së përbashkët rajonale të OKB-së "Rinia për përfshirje, barazi dhe besim", mbështetur nga Fondi i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për ndërtimin e paqes.

Senad Alirifa jep dorëheqje nga pozita e trajnerit



MALISHEVË, 24 TETOR - FC Malisheva ka njoftuar se trajneri Senad Alirifa ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë. Klubi nga Malisheva ka bërë me dije se pozitën e kryetrajnerit do ta ushtrojë asistenti i parë i skuadrës, Qëndrim Kida. "Sot me keqardhje kemi pranuar dorëheqjen e trajnerit Senad Alirifa nga pozita e kryetrajnerit në FC Malisheva. Pas një periudhe të vështirë në klub dhe pas disa rezultateve jo të kënaqshme kohën e fundit, trajneri Alirifa ndjeu përgjegjësinë profesionale për të dhënë dorëheqje edhe pse përgjegjësia për rezultatet e

fundit jo të mira ishte e të gjithë neve në FC Malisheva dhe jo vetëm e tij. Nga sot e tutje pozitën e kryetrajnerit do ta marrë asistenti i parë i skuadrës, Qëndrim Kida, i cili edhe zyrtarisht është emëruar kryetrajner në FC Malisheva", ka njoftuar FC Malisheva. Me këtë rast, FC Malisheva ka falënderuar trajnerin Alirifa për punën profesionale dhe angazhimin e tij duke i dëshiruar suksese në të ardhmen dhe shëndet të mirë. "Po ashtu, përgëzojmë trajnerin e ri Kida duke i uruar suksese dhe rezultate pozitive në të ardhmen", ka njoftuar FC Malisheva.

Shkarkohet trajneri i Ajaksit

AMSTERDAM, 24 TETOR - Trajneri i Ajaksit, Maurice Steijn, është larguar nga klubi përmes një

marrëveshjeje të dyanshme pas një fillimi të keq të sezonit. Klubi holandez ka vendosur ta largojë Steijnin

pas humbjes 4:3 nga Utrechtin në fundjavë në kuadër të Eredivisies, ligës elitare holandeze. Me këtë humbje

giganti i futbollit botëror numëron vetëm pesë pikë nga shtatë ndeshje teksa ndodhet në rrezik për të rënë





MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

D P A

Departamenti për punë administrative

Mitrovicë 25.10.2023 / Nr. 151/012

Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Kompania Rajonale Ujësllësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, shpallë këtë:

K O N K U R S

(Për plotësimin e vendit të punës, punë provuese gjashtë (6) muaj me mundesi vazhdimi)

I. Pozita e punës: Drejtor Komercial.

Kompania: Kompania Rajonale Ujësllësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë.

Paga bazë: 991.25 Euro, sipas Rregullores mbi ndarjen e të ardhurave të KRU "Mitrovica".

Kushtet për punësim (edukimi i kërkuar):

Përgatitja profesionale: Titulli "Master", në drejtimet (Ekonomik, Menaxhment, Administrim Biznesi).

Përvoja e punës: Tri (3) vite përvojë pune, prej tyre së paku dy (2) vite punë menaxheriale

Pozita e hapur: Një (1) Drejtor Komercial.

Kushtet e veçanta:

- ✓ Njohuri të larta të raportimit të performancës dhe proceseve financiare/buxhetore,
- ✓ Të jetë shumë i orientuar drejt qëllimeve dhe zotëroj aftësi të shkëlqyera ndër personale dhe komunikuese,
- ✓ Aftësi të shkëlqyera organizative dhe udhëheqjes,
- ✓ Njohja e punës me kompjuter, programe softuerike (aplikacione) që funksionojnë në kuadër të Ndërmarrjes.

Detyrat dhe përgjegjësitë e punës:

- Të jetë i/e aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat e punës,
- Drejton, organizon dhe zbaton punët dhe detyrat e caktuara në kompani në Departamentin Komercial si dhe të Marrëdhënies me konsumatorët dhe çështjet specifike (Faturimi, Inspektimi),
- Udhëheq dhe këshillon gjithë personelin vartës për të siguruar rezultate efektive,
- Drejton dhe përgatitë të dhënat komerciale të kompanisë për planin e biznesit,
- Shqyrton dhe aplikon procedurat e aprovuara për sektorin komercial,
- Koordinon, kontakton dhe bashkëpunon në ofrimin e të gjitha të dhënave te aktivitetit të departamentit në varësi,
- Analizon klimën e treguesve dhe tendencat e biznesit në aspektin komercial për të ndihmuar drejtuesit e lartë në krijimin e planeve strategjike për të ardhmen,
- Interpreton informacionin sektorial për të siguruar raportet e nevojshme për vendim-marrje,
- Monitoron procesin e faturimit dhe shitjeve, nivelin e performancës në njësit vartëse, llogaritë e arkëtueshme,
- Sipas autorizimeve të KE-se përfaqëson Ndërmarrjen përpara palëve të interesit,
- Sipas kërkesave përpilon raporte mujore dhe vjetore për ARRU dhe institucione qeveritare,
- Është pjesë ndërlidhëse midis departamentit dhe njësitë e tjera,
- Kryen detyra të tjera, me ZKF-ne koordinon aktivitetet rreth mirëmbajtjes së llogarive të arkëtueshme dhe kryen detyra të caktuara nga Kryeshefi Ekzekutiv, sipas fushës së kompetencës dhe pozitës,
- Për punën që e kryen i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

Dokumentet e kërkuar:

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me këtë aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Letër motivimi,
- Diploma e Universitare (kopja e noterizuar, kurse diploma nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmia nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmi mbi eksperiencën e punës,
- Një deklaratë nën betim (për pozitën: Drejtor Komercial).
- Kopja e letërnjoftimit.

Aplikacionet mund të merrën ueb-faqën e Kompanisë KRU "Mitrovica" Sh.a. në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/>, si dhe në zyrën për burime njerëzore dhe të dorëzohen në të njëjtën zyrë së bashku me dokumentacionin përcjellës në formë fizike.

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit nga data **25.10.2023** deri me datën **08.11.2023**.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

Dokumentet e pranuar të aplikantëve në fotokopje nuk kthehen.

Kompania Rajonale Ujësllësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë inkurajon kandidatet femra, kandidatët nga grupet minoritare si dhe personat me aftësi të kufizuara të aplikojnë.

KRU "Mitrovica" Sh.A. Mitrovicë.



MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

D A P

Departament za Administrativne Poslove

Mitrovica 25.10.2023 Br 151/012

Na osnovu Administrativnog uputstva br. 07/2017, Regionalno vodovodno preduzeće "Mitrovica" d.d. u Mitrovici, objavljuje:

K O N K U R S

(Za popunjavanje radnih mesta probni rad u trajanju od šest (6) meseci, sa mogućnošću produženja)

I. Radno mesto: Komercijalni Direktor.

Kompanija: Regionalna Kompanija Vodovod „Mitrovica“ D.D. u Mitrovici.

Osnovna plata će biće 991.25 Euro po uredbi o raspodeli prihoda.

Uslovi za zapošljavanje (potrebno obrazovanje)

Stručna sprema: Maester (Ekonomija, Menadžment, Poslovna Administracija)

Radno iskustvo: 3 godina radnog iskustva, od kojih najmanje 2 godine menadžerski

Otvorena pozicija: Jedan (1) Komercijalni Direktor.

posebni uslovi;

- ✓ Visoko poznavanje izveštavanja performanse i finansijskih/budžetskih procesa,
- ✓ Da bude veoma orijantisan ka cilju i imati odlične međuljudske komunikacijske veštine,
- ✓ Odlične organizacione i rukovodeće sposobnosti,
- ✓ Poznavanje rada sa kompjuterom, softverskim programima (aplikacije) koje funkcionišu u okviru Preduzeća.

Radne obaveze i odgovornosti:

- Da bude sposoban/na za obavljanje radnih obaveza sa punim radnim vremenom i bez ograničenja,
- Da usmerava, organizuje i realizuje poslove i zadatke u preduzeću u Sektoru Komercijale, kao i donose sa potrošačima i specifična pitanja (fakturisanje, inspekcija sa potrošačima),
- Da vodi i savetuje svo podređeno osoblje kako bi osigurali efektívne rezultate,
- Da upravlja i pripremi komercijalne podatke kompanije za poslovni plan,
- Da pregledai procenjuje odobrene procedure za komercijalni sektor,
- Da koordinira, kontaktira i saraduje u pružanju svih podataka o aktivnostima poredenog odeljenja,
- Da analizira komercijalnu klimu i poslovne trendove marketinških stručnjaka kao bi pomogli višim rukovodiocima u kreiranju strateških planova za budućnost,
- da tumači sektorske informacije kako bi obezbedio neophodne izveštaje za donošenje odluka,
- Da prati proce fakturisanja i prdaje, nivo učinka u podređenim jedinicama, potraživanjima,
- Da po ovlašćenjima EK zastupa Preduzeće pred zainteresovanim strankama,
- Da prema zahtevima izradi mesečne i godišnje izveštaje za ARRU i vladinih institucija,
- Da je deo za vezu između odeljenja i drugih jedinica,
- Da izvrši druge zadatke, sa ZKF koordinira aktivnosti oko održavanja potraživanja i da završi određene zadatke od strane glavnog Izvršnog Direktora, prema oblasti nadležnosti i položaja,
- Za poslove koje izvršava odgovara izvršnom Direktor.

Traženi dokumenti:

Zainteresovani kandidati moraju da popune prijavu Kompanije i da uz ovu prijavu prilože sledeću dokumentaciju:

- CV (biografija),
- Motivaciono pismo,
- Univerzitetska diploma (overena kopija, dok diplome sa univerziteta u inostranstvu moraju biti overene kod notara),
- Dokaz nadležnog suda koji nije pod istragom, koji važi najviše 6 meseci,
- Dokaz o stručnoj obuci,
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Izjava pod zakletvom (za poziciju: komercijalni direktor).
- Kopija lične karte,

Prijave se primaju na sajtu Preduzeća RVP „Mitrovica“ d.d. na adresi <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset/> kao i u kancelariji za ljudske resurse i dostavlja se istoj kancelariji zajedno sa pratećom dokumentacijom.

Konkurs će biti ovcen 15 dana od dana objavljivanja u sredstvima informisanja pocevsi od dana 25.10.2023 do 08.11.2023.

Prijave podnete nakon roka se ne prihvataju, a nepotpune se odbijaju.

Prihvataćena fotokopirana dokumenta podnosiocima prijava se ne vraćaju. Regionalno vodovodnopreduzeće „Mitrovica“ d.d. u Mitrovici podstiče kandidatkinje, kandidate iz manjinskih grupa, kao i osobe sa invaliditetom da se prijave. RVP „Mitrovica“ d.d. Mitrovica.



Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimin Administrativ Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Nr.07/2017, Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, shpallë:

K O N K U R S

(Për plotësimin e vendit të punës, punë provuese gjashtë (6) muaj me mundësi vazhdimi)

I. Emërtimi i vendit të punës: Inxhinier përgjegjës- Hidroteknikë

Përgatitja profesionale: Fakulteti Teknik - Hidroteknikë

Përvoja e punës: 2 vite

Numri i kryerësve: (2)

Koeficienti i pagës: 632.39 Euro

Aftësitë e buta: aftësitë e mira të komunikimit, etikën e punës, punën ekipore, vendimarrjen, menaxhimin e kohës, motivimin, fleksibilitetin, zgjidhjen e problemeve dhe mendimin kritik.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Punon në kalkulimin e çmimeve për paramasë dhe parallogaritë dhe përgatit apo kompletin dokumentet për projektet e ujësjellësit (kompletimin e tenderit)
- Bashkëpunon me shërbimet dhe departamentet tjera e sidomos me zyrën e GIS-it në KRU Mitrovica,
- Pas kordinimit të punëve në zyre, të planifikimit dhe punimit të projekteve sipas kërkesës së shërbimeve obligohet të përcillen zhvillimet e punimeve edhe në teren,
- Përgadit tërë dokumentacionin teknik për kryerjen e punëve dhe të njejtin ia dërgon Shefit të shërbimit të projektimit dhe zyrës së GIS-it.
- Bashkëpunon dhe koordinon punën me stafin inxhinierik dhe GIS në hartimin e projekteve investive në fushën e Hidroteknikës.
- Bënë mbikëqyrjen e implementimit të projekteve.
- Për mirëmbajtjen dhe operimin e rregullt të aseteve të kompanisë bënë plane për tu përgjigjur në çdo sfidë siç janë planet reaktive, pro aktive dhe preventive.
- Bënë planin e punës, planin vjetor dhe të remonteve të mirëmbajtjes së objekteve në pikëpamje investive dhe të rregullt nëse është e aplikueshme duke paraparë materialin e nevojshëm dhe pjesët e ndërrimit
- Formon dokumentacionin e rregullt dhe kujdeset për ruajtjen e tij;
- Është përgjegjës ndaj ligjeve shtetërore që rregullojnë veprimtarinë nga lëmitë e profileve të këtij shërbimi dhe kujdeset që ti marrë masat gjegjëse sidomos nga mbrojtja higjieno - teknike dhe të mbrojtjes në punë;
- Evidenton defektet dhe dëmtimet në rrjetin e ujësjellësit në pronësi të KRU-së deri te prona e konsumatorit, dhe merr masa preventive që me kohë të eliminohen këto defekte dhe dëmtime deri në funksionimin e rregullt të rrjetit që furnizon konsumatorët e tërë rrjetit, si dhe pas evidentimit i rexhistron ato në sistemin GIS
- Përpilon planin e zhvillimit afatmesëm dhe afatgjatë si dhe zgjerimin e rekonstruimit e objekteve të KRU-së , në mënyrë që të sigurohet funksionaliteti dhe efikasiteti i plotë i punës së tij;
- Në kuadër të vet dhe në kuadër tjetër plotësues projekton objekte hidroekonomike dhe hidrondërtimore për Kompaninë dhe për palët e treta dhe me mjetet e veta ose plotësuese i realizon ato kur të sigurohen mjetet financiare;
- Pranon punë dhe përgjegjësi të tjera nga udhëheqësit konform nevojave të kompanisë.
- Kryen punë të tjera dhe i raporton Shefit të shërbimit dhe Menaxherit të Departamentit.

Dokumentet e kërkuara:

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me këtë aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Letër motivimi,
- Diploma e Universitare (kopja e noterizuar, kurse diploma nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmi nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmi mbi eksperiencën e punës,
- Kopja e letërnjoftimit.

Mënyra e aplikimit:

- Aplikacionet mund të merren ueb-faqen e Kompanisë KRU "Mitrovica" Sh.A. në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset> si dhe fizikisht në zyrën për Burime Njerëzore, dhe të dorëzohen në të njëjtën zyrë së bashku me dokumentacionin përcjellës në formë fizike.
- Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit nga data 25.10.2023 deri me datën 08.11.2023.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.
- Dokumentet e pranura të aplikantëve në fotokopje nuk kthehen.
- Kompania Rajonale Ujësjellësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë inkurajon kandidatet femra, kandidatët nga grupet minoritare si dhe personat me aftësi të kufizuar të aplikojnë.

VËREJTJE: Kandidatët të cilët paraqesin aplikacionin e pa-plotësuar, apo nuk i bashkëngjisni dokumentet e kërkuara si në konkurs, aplikimet e tyre do të refuzohen dhe të njëjtin nuk do të i nënshtrohen procedurës së rekrutimit.



U skladu sa članom 8. Zakona o radu br. 03/L-212 i Administrativnog uputstva za regulisanje tenderskih postupaka u javnom sektoru br. 07/2017, Regionalno vodovodno preduzeće „Mitrovica“ d.d. u Mitrovici, je objavila ovaj:

OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

(Za popunjavanje slobodnih radnih mesta šest (6) meseci probni rad sa mogućnošću produženja)

I. Naziv radnog mesta: Odgovorni inženjer- Hidroteknika

Profesionalna kvalifikacija: Tehnički Fakultet - Hidroteknika

Radno iskustvo: 2 godine

Broj pozicija: (2)

Koeficijent plate: 632.39 €

Meke veštine: dobre komunikacijske veštine, radna etika, timski rad, donošenje odluka, upravljanje vremenom, motivacija, fleksibilnost, rešavanje problema i kritičko razmišljanje.

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Radi na kalkulaciji cena za predmere i predračune i priprema ili kompletira dokumentaciju za projekte vodosnabdevanja (kompletiranje tendera),
- Saraduje sa drugim službama i odeljenjima, posebno sa GIS kancelarijom u RVP Mitrovica,
- Nakon koordinacije rada u kancelariji, planiranja i rada na projektima po zahtevu službi, zaposleni je dužan da prati razvoj radova na terenu,
- Priprema svu tehničku dokumentaciju za izvođenje radova i šalje je šefu projektantske službe i GIS kancelariji,
- Saraduje i koordinira rad sa inženjerskim i GIS kadrom na projektovanju investicionih projekata iz oblasti hidrotehnike,
- Nadzire realizaciju projekata,
- Za održavanje i redovno funkcionisanje imovine kompanije, zaposleni planira da odgovori na svaki izazov, kao što su reaktivni, proaktivni i preventivni planovi,
- Priprema plan rada, godišnji plan i plan sanacije i održavanja objekata u smislu investicionog i redovnog održavanja, po potrebi, uključujući planiranje potrebnog materijala i rezervnih delova,
- Izrađuje redovnu dokumentaciju i stara se o njenom očuvanju,
- Odgovoran je za državne zakone koji regulišu delatnost u oblastima profila ove službe i stara se o preduzimanju odgovarajućih mera, posebno u pogledu higijensko – tehničke zaštite i zaštite na radu,
- Identifikuje kvarove i oštećenja na vodovodnoj mreži u vlasništvu RVP do imovine potrošača i preduzima preventivne mere za otklanjanje ovih kvarova i oštećenja na vreme dok ne obezbedi uredan rad mreže koja snabdeva potrošače cele mreže, uključujući i njihovu registraciju u GIS sistemu,
- Priprema srednjoročni i dugoročni plan razvoja, kao i proširenja i rekonstrukcije objekata RVP, kako bi se obezbedila puna funkcionalnost i efikasnost njegovog rada,
- U okviru poslova i drugih komplementarnih okvira projektuje hidro-privredne i hidrogradevinske objekte za Preduzeće i za treća lica i sopstvenim ili komplementarnim sredstvima ih izvodi kada su obezbedena finansijska sredstva,
- Prihvata radne i druge obaveze od rukovodilaca prema potrebama kompanije,
- Obavlja i druge poslove i izveštava šefu službe i rukovodioca odeljenja.

Potrebna dokumentacija:

Zainteresovani kandidati moraju popuniti prijavu Preduzeća i uz prijavu priložiti sledeću dokumentaciju:

- CV (Biografija),
- Motivaciono pismo,
- Univerzitetska diploma (overena kopija, dok diploma sa univerziteta u inostranstvu mora biti nostrifikovana),
- Dokaz nadležnog suda da nije pod istragom, ne stariji od 6 meseci,
- Dokaz o stručnom usavršavanju,
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Kopija lične karte.

Način prijave:

- Prijave se mogu dobiti na sajtu Preduzeća RVP „Mitrovica“ d.d. na adresi: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset>, kao i fizički u Službi za ljudske resurse, i dostaviti istoj kancelariji zajedno sa pratećom dokumentacijom u štampanom obliku.
- Konkurs će biti otvoren 15 dana od dana objavljivanja od 25.10.2023 do 08.11.2023.
- Prijave dostavljene nakon isteka roka se ne prihvataju.
- Prihvaćena dokumenta podnosiocima prijava u fotokopijama se ne vraćaju.
- Regionalno Vodovodno Preduzeće "Mitrovica" d.d. u Mitrovici podstiče kandidatkinje, kandidate iz manjinskih grupa, kao i osobe sa invaliditetom da se prijave.

NAPOMENA: Kandidatima koji podnesu nepotpunu prijavu, ili ne prilože traženu dokumentaciju kao u oglasu za konkurs, prijave će biti odbijene i neće biti predmet postupka prijema.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Dyer dhe Dritare - Enisi" SH.P.K. me seli në Pejë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me Nr: Fiskal: 601555834 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Dyer dhe Dritare - Enisi" D.O.O. od Peç, donelo odluku o prestani rada sa fiskalnom broja. 601555834 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Dyer dhe Dritare - Enisi" L.L.C. with headquarters Peja, has come to the decision to quit its business, fiscal number: 601555834 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

-Naser Shunjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës Teknike "Nexhmedin Nixha".

Ujëvara Rama nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e testit të maturës të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi".

Liberta Spahija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat, diplomën dhe certifikatën e maturës të Gjimnazit "Hajdar Dushi".

Edmonda Kadriu shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Xheladin Deda".

Urimit Rent a car shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 811430941.

Aksa Advertisement SH.P.K. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 811284299.

Besart Sadiku B.I. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810174673.

B2 SH.P.K. shpall te pavlefshme certifikatën e biznesit nr. 810129347.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

